

Ekskluzive

Ekskluzive | Tmerr para shtëpisë në Rahovec: Dy persona me maska dhe pistoletë sulmojnë një grua, ia marrin 5 mijë euro



Sinjali.com

12 Shtator 2026 11:45



Një grua në Rahovec është përballur mbrëmë me momente tmerrri, pasi dy persona të maskuar dhe të armatosur dyshohet se e kanë sulmuar fizikisht pranë shtëpisë së saj dhe, nën kërcënimin e pistoletës, ia kanë grabitur çantën me mijëra euro.

Sinjali mëson se rasti ka ndodhur rreth orës 23:25, në rrugën “Luftëtari”, në Lagjen e Epërme të Rahovecit.

Sipas informacioneve të para, viktimja ndodhej pranë shtëpisë së saj kur është përballur me dy persona të maskuar. Ata dyshohet se e kanë sulmuar fizikisht, ndërsa njëri prej tyre ishte i armatosur me pistoletë.

Nën kërcënimin e armës, të dyshuarit ia kanë marrë çantën e dorës, brenda së cilës gruaja ka deklaruar se kishte rreth 5 mijë euro.

Pas grabitjes, dy personat janë larguar nga vendi i ngjarjes, ndërsa viktimja ka marrë trajtim mjekësor nga ekipi i autoambulancës në vendngjarje.

Rasti ka vënë në lëvizje njësitë e Stacionit Policor në Rahovec dhe hetuesit rajonalë, të cilët kanë nisur veprimet për identifikimin dhe kapjen e të dyshuarve.

Për rastin është njoftuar edhe Prokurori i Shtetit, me urdhër të të cilit është iniciuar rasti për veprën penale “Grabitje”.

Të dyshuarit mbeten ende të paidentifikuar, ndërsa hetimet për zbardhjen e plotë të rastit po vazhdojnë.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera